# MENAXHIMI I QËNDRUESHËM I UJIT PËRBALLË *Ndryshimeve Klimatike*

KONFERENCA DHE EKSPOZITA E 13-TË E PËRBASHKËT BALLKANIKE



## BROSHURA E KONFERENCËS DHE EKSPOZITËS

11-12-13 NËNTOR 2
DURRËS, SHQIPËRI

SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

SHUKOS
SHODATA E UJËSJELLËSVE DHE KANALIZIMIT TË KOSOVËS


| | |
|---|---|
| Konferenca dhe Ekspozita: | info@BalkansJointConference.org |
| Programi i Konferencës: | program@BalkansJointConference.org |
| Tel SHUKALB: | +355 42 245 101, Mob: +355 69 6012782 |
| Tel SHUKOS: | +383 38 600 873, Mob: +383 44 182 497, +383 44 282 580 |

# Përmbajtja


Mirëseardhja ... 2

Konferenca... 3

*Regjistrimi në Konferencë.* ... 4

Ekspozita Teknike ... 5

*Regjistrimi në Ekspozitë* ... 5

*Plani i Stendave të Ekspozitës* ... 6

Mundësitë e Sponsorizimit në Ekspozitë. ... 8

Informacion Shtesë ... 8

Pyetje dhe Kontakte ... 10

Formulari i Regjistrimit në Konferencë ... 11

Formulari i Regjistrimit për Kompanitë Ekspozuese ... 14

## MIRËSEARDHJA

Në emër të SHUKOS dhe SHUKALB, kemi kënaqësinë t'ju ftojmë të merrni pjesë në Konferencën dhe Ekspozitën tonë të 13-të të Përbashkët Ballkanike, e cila do të zhvillohet në datat 11 – 13 Nëntor 2025, në qytetin bregdetar të Durrësit, në Shqipëri, në Grand Blue Fafa Resort.

Tema e konferencës së këtij viti "Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit përballë ndryshimeve klimatike", adreson një nga sfidat më urgjente mjedisore të kohës tonë. Ndryshimet klimatike tashmë po ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në disponueshmërinë, cilësinë, dhe shpërndarjen e ujit, duke prishur ekosistemet dhe kërcënuar qëndrueshmërinë e komuniteteve në të gjithë rajonin.

Menaxhimi i qëndrueshëm i ujit po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm ndërsa vendet e Ballkanit bëhen më të prekshme ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, duke përjetuar ngjarje më të shpeshta ekstreme të motit. Në të njëjtën kohë, shumë Kompani Ujësjellës Kanalizime (UK) në rajon vazhdojnë të përballen me sisteme të vjetëruara, humbje të mëdha të ujit dhe kapacitete të kufizuara për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, duke e bërë më të vështirë ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotur.

Ndërsa vendet e Ballkanit shkojnë drejt integrimit në BE, kompanitë UK përballen me një provë kritike: Përmbushjen e direktivave të BE-së për ujin dhe ndyshimet klimatike. Kompanitë UK duhet të kuptojnë dhe të përshtaten me një sërë rregullash të reja, të modernizojnë infrastrukturën e vjetëruar në përputhje me standarde të larta mjedisore dhe të sigurojnë investime të konsiderueshme për të mbështetur këto ndryshime. Nga ana tjetër, kalimi drejt teknologjive të përparuara dhe praktikave të qëndrueshme ndaj klimës kërkon aftësi të reja, institucione më të forta dhe kapacitete më të mëdha operacionale. Duke u përballur me këto sfida drejtpërdrejt, kompanitë UK mund t'i shndërrojnë këto presione në progres dhe aftësi për t'u përshtatur me një klimë që ndryshon me shpejtësi.

Konferenca dhe Ekspozita e Përbashkët Ballkanike është konsoliduar si një event kryesor për ndarjen e njohurive dhe rrjetëzimin brenda sektorit të ujit në Ballkanin Perëndimor. Ajo mirëpret mbi 500 pjesëmarrës nga Rajoni i Ballkanit, Evropa dhe nga e gjithë bota. Konferenca ofron një platformë dinamike për profesionistët e ujit, politikëbërësit dhe ekspertët e industrisë për t'u angazhuar në dialog kuptimplotë, për të shkëmbyer ekspertizë dhe për të ndarë praktikat më të mira. Kjo frymë bashkëpunimi nxit inovacionin dhe përparimin në sektorin ujësjellës kanalizime, si në nivel rajonal ashtu edhe global.

Paralelisht me programin teknik, do të organizohet edhe një Ekspozitë e gjerë e Pajisjeve, Teknologjive dhe Shërbimeve, e cila do të prezantojë zgjidhje dhe inovacione nga kompani lidere në sektorin e ujit në Ballkan. Kjo do t'i mundësojë pjesëmarrësve të eksplorojnë zhvillimet më të fundit për përballjen me sfidat e klimës dhe përmirësimin e menaxhimit të ujit.

Ju mirëpresim në Konferencën tonë të Përbashkët, ku do të bashkojmë forcat për të përparuar drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme të ujit për rajonin e Ballkanit, përballë sfidave të klimës në ndryshim.



Z. Petrit Tare
President
SHUKA**LB**



Z. Arsim Fetahu
President
SHUKOS

## KONFERENCA

Programi i Konferencës do të mundësojë një diskutim të gjerë dhe shumëdimensional, duke përfshirë tema që variojnë nga aspektet politike dhe teknike deri te çështjet e menaxhimit brenda sektorit të ujit. Ai do të shërbejë si një platformë për pjesëmarrësit që të ndajnë njohuritë dhe përvojat e tyre në adresimin e sfidave të sektorit të ujit. Për më tepër, konferenca do të krijojë mundësi të vlefshme rrjetëzimi për profesionistët në sektorin e ujit të rajonit të Ballkanit.

Individët të cilët dëshirojnë të prezantojnë në Konferencë janë lutur të dorëzojnë një abstrakt që lidhet me një nga temat kryesore të konferencës të listuara më poshtë. Abstraktet do të vlerësohen nga Komiteti Teknik i Programit. Thirrja për abstrakte është e hapur deri më datën 12 shtator 2025.

Temat kryesore të Konferencës janë:

- Qeverisja dhe Politikat për Shoqëritë UK
- Kuadri Rregullator
- Menaxhimi i Infrastrukturës së Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve
- Menaxhimi i Burimeve Ujore
- Menaxhimi Financiar i Shoqërive UK
- Menaxhimi i Operimit Teknik të Shoqërive UK
- Menaxhimi i Ujit të Trajtuar dhe Llumit
- Shërbimi ndaj Klientit
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Për më shumë informacion mbi Thirrjen për Abstrakte dhe dorëzimin e abstrakteve, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të Konferencës nëpërmjet këtij LINKU, ose na kontaktoni në program@BalkansJointConference.org.



## REGJISTRIMI NË KONFERENCË

Tarifat e Pjesëmarrjes në Konferencë në Euro

| Kategoria e Pjesëmarrjes | Tarifat e regjistrimit deri në 30 shtator | | Tarifat e regjistrimit 01 tetor – 07 nëntor | |
|---|---|---|---|---|
| | Anëtar* | Jo-anëtar | Anëtar* | Jo-anëtar |
| Shoqëri UK (person) | 135 | 150 | 145 | 160 |
| Kompani private | 170 | 185 | 180 | 210 |
| Individë | 135 | 150 | 145 | 160 |
| Profesionistë të rinj | 105 | 105 | 105 | 105 |
| Studentë | 75 | 75 | 75 | 75 |
| Institucione Publike | 135 | 150 | 145 | 160 |
| OJF/ Donatorë | N/A | 170 | N/A | 185 |

**) Anëtar i SHUKALB dhe/ose SHUKOS*

Tarifa e regjistrimit përfshin hyrjen në sesionet teknike dhe ato plenare, pritjen gala; dreka dhe pushimet për kafe dhe eventin social.

### Si të Regjistroheni

Regjistrimi në Konferencë mundësohet përmes dy mënyrave:

1- Duke u regjistruar online përmes linkut https://crm.shukalb.al/civicrm/event/info/?reset=1&id=112, ose
2- Duke plotësuar Formularin dhe duke e dërguar sërish tek adresa: info@BalkansJointConference.org

Ne ju inkurajojmë të regjistroheni në datat e mësipërme. Gjithsesi, nëse ju nuk arrini të regjistroheni në këto data, mund të regjistroheni gjatë ditëve të Konferencës.

### Pagesa

Ju mund të kryeni pagesën tek ajo llogari bankare, të cilën e konsideroni më të përshtatshme për ju ose kompaninë tuaj.

| SHUKALB | SHUKOS |
|---|---|
| SHUKALB, Pjetër Bogdani, Tiranë, Shqipëri | Rr. "Bill Clinton", Objekti- "Iber-Lepenc", nr 13, kati I-re, Prishtinë,Kosovë |
| **Banka:** PROCREDIT BANK, Shqipëri<br>**Emri i përfituesit:** Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë<br>**Nr. i llogarisë:** 50-006143-01-02 (EUR)<br>**IBAN:** AL29209415070000500061430102<br>**SWIFT**: FEFAALTRXXX | **Banka:** NLB Prishtina sh.a<br>**Banka Ndërmjetëse:** LJBASI2X Nova Ljubljanska Banka dd, Ljubljana Slovenia<br>**Emri i përfituesit:** SHUKOS<br>**Nr. i llogarisë:** 17-00-200000018975<br>**IBAN:** XK051700200000018975<br>**SWIFT**: NLPRXKPR |

## EKSPOZITA TEKNIKE

Kompanitë e sektorit privat janë partnerë kyç për shoqëritë ujësjellës kanalizime, duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh që mbështesin ofrimin efektiv të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve. Nga pajisjet dhe teknologjitë te konsulenca, softuerët dhe zgjidhjet operative, kontributet e tyre janë thelbësore jo vetëm për operacionet e përditshme, por edhe për përparimin e vazhdueshëm të sektorit.

Në Konferencë, kompanitë ekspozuese e pasurojnë shumë përvojën duke prezantuar zhvillimet më të fundit, duke rritur njohuritë e pjesëmarrësve dhe duke kontribuar në mënyrë aktive në program dhe diskutime. Në këmbim, ekspozuesit përfitojnë nga qasja e drejtpërdrejtë në një audiencë të gjerë profesionistësh dhe vendimmarrësish, duke krijuar mundësi të vlefshme për vizibilitet dhe networking. Konferenca mirëpret kompani nga e gjithë bota për të prezantuar zgjidhjet e tyre dhe për të marrë pjesë në formësimin e bisedës rreth sfidave të sotme të ujit dhe ujërave të ndotura.

## REGJISTRIMI NË EKSPOZITË

Hapësira e Ekspozitës është e organizuar me stenda nga 6 m² dhe 8 m². Hapësira e stendave të Ekspozitës mund të blihen sipas metrave katrorë me çmimet e mëposhtme:

| Kompani anëtare të SHUKALB/SHUKOS** | Kompani jo-anëtare të SHUKALB/SHUKOS |
|---|---|
| 170 Eur/m² | 220 Eur/m² |

**) ky çmim i përket kompanive, të cilat anëtarësohen tek SHUKALB/SHUKOS përpara datës 30.09.2025*

Blerja e stendës së ekspozitës përfshin:

- Shfaqja e emrit dhe logos së kompanisë në stendë
- Shfaqja e logos së kompanisë tek faqja e internetit të Konferencës dhe Ekspozitës (faqja e kompanive ekspozuesve)
- Regjistrim falas në Konferencë për dy përfaqësues të kompanisë që përfshin:
    - Hyrjen në sesionet e konferencës
    - Pushimet e drekës dhe kafet për dy ditë (12 dhe 13 nëntor 2025)
    - Pritjen e Mirëseardhjes (11 nëntor 2025)
    - Eventin Social (12 nëntor 2024)

### Formulari i Regjistrimit

Kompanitë dhe institucionet e interesuara të ekspozojnë në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike do të mund të gjejnë Formularin e Regjistrimit bashkangjitur këtij njoftimi. Gjithashtu, është e mundshme që ky formular të shkarkohet nga faqja e internetit të Konferencës përmes LINKUT. Pasi ta plotësoni, ju lutemi, dërgojeni me e-mail tek info@BalkansJointConference.org

### Afatet e Regjistrimit

Afati i regjistrimit për kompanitë ekspozuese është data **15 tetor 2025**. Ju lutemi, vini re se preferenca për pozicionet dhe hapësirat e stendave do jetë sipas konfirmimit më të parë. Në momentin që merret konfirmimi për një stendë, kompania duhet të mbyllë pagesën brenda 10 ditësh nga konfirmimi, sipas informacionit qe jepet në Formularin e Regjistrimit.

## PLANI I STENDAVE TË EKSPOZITËS

Hapësira e Ekspozitës është e organizuar me stenda nga 6 m² dhe 8 m². Ju mund të shkarkoni planin më të fundit të stendave tek faqja e internetit të Konferencës dhe Ekspozitës www.BalkansJointConference.org



Facilitetet për hapësirat e ekspozimit

Hapësirat e ekspozimit kanë panele ndarëse, të cilat mund të përdoren për shfaqjen e posterave apo materialeve informuese. Emri i kompanisë do jetë i shfaqur, si dhe do ketë një tavolinë për materialet. Gjithashtu, do të ketë ndriçim elektrik 200 V -220V.

Vendosja dhe heqja e tabelave të ekspozimit

Ekspozuesit do të vendosin materialet e ekspozimit gjatë paradites së ditës së parë të Ekspozitës, dt. 11 nëntor 2025, duke filluar në orën 11:00 dhe duhet të mbarojnë vendosjen jo më vonë se deri në orën 17:00. Ekspozuesit do duhet të largojnë këto materiale në orën 17:00 të ditës së fundit të Ekspozitës, dt. 13 nëntor.

Emri dhe logo i ekspozuesve

Të gjithë Ekspozuesit duhet të sigurohen që së bashku me formularin e regjistrimit, të dërgojnë edhe logon e kompanisë së tyre në format AI, EPS ose PDF.



## MUNDËSITË E SPONSORIZIMIT NË EKSPOZITË

Sponsorizimi i Konferencës së Përbashkët Ballkanike shkon përtej rritjes së profilit të kompanisë suaj në sektorin rajonal të ujit - është gjithashtu një mënyrë kuptimplote për të mbështetur misionin e SHUKALB dhe SHUKOS. Vizioni i tyre i përbashkët është të ofrojnë mundësi të shkëmbimit të njohurive me cilësi të lartë dhe çmime të përballueshme në të gjithë Ballkanin. Duke u bërë sponsor, kompania juaj demonstron angazhimin e saj ndaj këtij vizioni dhe luan një rol aktiv në forcimin e sektorit të ujit në të gjithë rajonin.

Paketat e sponsorizimit që janë në dispozicion për këtë konferencë janë:

- Platinum — € 10,000 (Vetëm Një Sponsor)
- Gold — € 7,000 (Vetëm Një Sponsor)
- Silver — € 5,000 (Vetëm Një Sponsor)

Për më tepër detaje mbi benefitet e secilës prej këtyre paketave të sponsorizimit, ju lutem kontaktoni Alban Kushin (SHUKALB), në Tel: +355 42 245 101, Mob: +355 69 6012782, info@BalkansJointConference.org.

## INFORMACION SHTESË

### Gjuhët e Konferencës

Gjuhët e Konferencës janë shqipja dhe anglishtja.  Do ketë përkthim simultan.

### Vendi i Konferencës

Konferenca dhe Ekspozita do të zhvillohen në Durres, Shqipëri, në Grand Blue Fafa Resort, një nga hotelet më prestigjiozë në Shqipëri. I pozicionuar në zonën e Long Beach Golem, pranë Detit Adriatik, Grand Blue Fafa Resort ofron luksin dhe shërbimin më të mirë.

Grand Blue Fafa Resort është vetëm 10 km larg qendrës së qytetit të Durresit dhe 35 km nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranes.



### Akomodimi në hotel

Për pjesëmarrësit në Konferencë dhe Ekspozitë është rënë dakord me Grand Blue Fafa Resort për të pasur tarifa të veçanta. Gjithashtu, tek faqja e internetit të Konferencës dhe Ekspozitës, Akomodimi në Hotel, do të gjeni një listë të hoteleve aty pranë, me kontaktet e tyre përkatëse dhe distancën nga vendi i konferencës.

### Pritja e Mirëseardhjes

Pritja e Mirëseardhjes, në datën 11 Nëntor 2025, në orën 18:00, shënon hapjen e konferencës. Në event, do të jenë të ftuar zyrtarë të lartë të shtetit të Kosovës dhe të Shqipërisë, si dhe të ftuar dhe pjesëmarrës të Konferencës. Gjatë Pritjes së Mirëseardhjes do të bëhet hapja zyrtare e Ekspozitës, dhe miqtë do të ftohen të shohin produktet dhe shërbimet e kompanive ekspozuese në Konferencë.

### Drekat & Pushimet për kafe

Në tarifën e regjistrimit të Konferencës janë përfshirë pushimet për kafe si dhe drekat.




## PYETJE DHE KONTAKTE

Për çdo pyetje në lidhje me Konferencën dhe Ekspozitën na kontaktoni në:

| | |
|---|---|
| E-mail: | info@BalkansJointConference.org |
| Alban Kushi (SHUKALB) | Tel: +355 42 245 101, Cel: +355 69 6012782 |
| Fatbardha Muqiqi (SHUKOS): | Tel: +383 38 526 873, Cel: +383 44 926 646 |




# FORMULARI I REGJISTRIMIT NË KONFERENCË

Ju lutemi, plotësoni formularin e regjistrimit dhe dërgojeni tek sekretariati i Konferencës dhe Ekspozitës.

| | |
|---|---|
| E-mail: | info@BalkansJointConference.org |
| Alban Kushi, SHUKALB: | Tel: +355 42 245 101, Cel: +355 69 6012782 |
| Fatbardha Muqiqi, SHUKOS: | Tel: +383 38 600 873, Cel: +383 44 926 646 |

## 1. EMRI

a. APLIKIM INDIVIDUAL - Secili pjesëmarrës duhet të plotesojë formularin e regjistrimit.
   i. Z /Znj
   ii. Emri Mbiemri

## 2. INSTITUCIONI

a. Institucioni

b. Departmenti

## 3. KONTAKTE

a. E-mail

b. Tel/Celular

c. Adresa

d. Qyteti

e. Shteti

f. Kodi postar

g. Faqja e internetit

## 4. ANËTARËSIMI TEK SHUKALB OSE/DHE SHUKOS

A jeni ju anëtar i SHUKALB ose/dhe SHUKOS?

a. PO ☐

b. JO ☐

c. Dëshiroj të paguaj anëtarësimin për vitin 2025 ☐

   i. *Ju lutemi, kontaktoni me Shoqatën respektive duke përdorur kontaktet në fillim të këtij dokumenti.*

## 5. TARIFAT E PJESËMARRJES NË KONFERENCË (NË EURO)

Ju lutemi, shënoni në kategorinë që i përkon aplikimit tuaj:

| Kategoria e Pjesëmarrjes | Tarifat e Pjesëmarrjes deri në 30 shtator | | Tarifa e Pjesëmarrjes 01 tetor – 01 nëntor | |
|---|---|---|---|---|
| | Anëtar* | Jo-anëtar | Anëtar* | Jo-anëtar |
| Shoqëri UK/ person | 135 | 150 | 145 | 160 |
| Kompani private | 170 | 185 | 180 | 210 |
| Individë | 135 | 150 | 145 | 160 |
| Profesionistë të rinj | 105 | 105 | 105 | 105 |
| Studentë | 75 | 75 | 75 | 75 |
| Institucione Publike | 135 | 150 | 145 | 160 |
| OJF/ Donatorë | N/A | 170 | N/A | 185 |

**) Anëtar i SHUKOS dhe/ose SHUKALB*

Tarifa e regjistrimit përfshin hyrjen në sesione, pritjen gala; drekat, dhe pushimet për kafe

## 6. TË DHËNAT BANKARE PËR PAGESËN

Ju lutemi, vini re se regjistrimi juaj do të jetë i plotë pasi ne të konfirmojmë pagesën tuaj të regjistrimit.
Ju mund të kryeni pagesën tek ajo llogari bankare, të cilën e konsideroni më të përshtatshme për ju.

<table>
<tr>
<td>SHUKALB<br>SHUKALB, Pjeter Bogdani, Tiranë, Shqipëri<br><br>Banka: PROCREDIT BANK, Shqipëri<br>Emri i përfituesit: Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë<br>Nr. i llogarisë: 50-006143-01-02 (EUR)<br>IBAN: AL29209415070000500061430102<br>SWIFT: FEFAALTRXXX</td>
<td>SHUKOS<br>Rr. "Bill Clinton", Objekti- "Iber-Lepenc", nr 13, kati I-re, Prishtinë,Kosove<br><br>Banka: NLB Prishtina sh.a<br>Banka Ndërmjetëse: LJBASI2X Nova Ljubljanska Banka dd, Ljubljana Slovenia<br>Emri i përfituesit: SHUKOS<br>Nr. i llogarisë: 17-00-200000018975<br>IBAN: XK051700200000018975<br>SWIFT: NLPRXKPR</td>
</tr>
<tr>
<td colspan="2">SHËNIM: Ju lutemi paguani shumën e plotë të shënuar në faturë. Komisionet bankare i takojnë pjesëmarrësit.</td>
</tr>
</table>

## 7. FIRMA

| | |
|---|---|
| Emri | |
| Data | |
| Firma | |




## FORMULARI I REGJISTRIMIT PËR KOMPANITË EKSPOZUESE

Ju lutemi, plotësoni formularin e regjistrimit dhe dërgojeni tek sekretariari i Konferencës dhe Ekspozitës.

| | |
|---|---|
| E-mail: | info@BalkansJointConference.org |
| Fatbardha Muqiqi, SHUKOS: | Tel: +383 38 600 873, Cel: +383 44 926 646 |
| Alban Kushi, SHUKALB: | Tel: +355 42 245 101, Cel: +355 69 6012782 |

## 1. KOMPANIA EKSPOZUESE DHE INFORMACION MBI KONTAKTET

- Emri i kompanisë
- Personi i kontaktit
- Departmenti
- Telefon
- Celular
- E-mail
- Adresa
- Shteti

## 2. TIPI I KOMPANISË

Ju lutemi, shënoni se cilës kategori i përket kompania juaj:

- Kontraktues për menaxhim ☐
- Konsulencë inxhinjerike ☐
- Kontraktues për ndërtim ☐
- Tregtues pajisjesh (pompa, etj.) ☐
- Tregtues materialesh (tuba, etj) ☐
- Tregtues kimikatesh ☐
- Tjetër (ju lutemi, specifikoni) ☐

## 3. HAPËSIRA PËR EKSPOZITË

Ju lutemi, shënoni kategorië që ju përket:

| Stenda* | Kompani anëtare të SHUKALB/SHUKOS | Kompani jo-anëtare të SHUKALB/SHUKOS |
|---|---|---|
| Stendë 6 $m^2$ | ☐ 1,020 Eur | ☐ 1,320 Eur |
| Stendë 8 $m^2$ | ☐ 1,360 Eur | ☐ 1,760 Eur |

**ky çmim i përket kompanive, të cilat anëtarësohen tek SHUKOS/SHUKALB përpara datës 30.09.2024*

Ju lutemi, vini re se preferenca për pozicionet dhe hapësirat e stendave do jetë sipas konfirmimit më të parë

## 4. REGJISTRIMI I PËRFAQËSUESVE TË KOMPANISË

PJESËMARRËSI 1

Emri

Pozicioni

Telefoni

E-mail

PJESËMARRËSI 2

Emri

Pozicioni

Telefoni

E-mail

## 5. INFORMACION BANKAR PËR PAGESËN E EKSPOZITËS

Ju mund të kryeni pagesën tek ajo llogari bankare më poshtë, të cilën e konsideroni më të përshtatshme. Ju mund të konfirmoni pagesën e kryer duke dërguar një kopje të skanuar të pagesës tek kontaktet, të cilat gjenden në fillim të Formularit të Regjistrimit. Ju lutemi, procedoni me pagesën jo më vonë se 10 ditë nga dita e dërgimit të këtij formulari.

| | |
|---|---|
| SHUKALB<br>SHUKALB, Pjeter Bogdani, Tiranë, Shqipëri<br><br>**Banka:** PROCREDIT BANK, Shqipëri<br>**Emri i përfituesit:** Shoqata Ujësjellës Kanalizime e Shqipërisë<br>**Nr. i llogarisë:** 50-006143-01-02 (EUR)<br>**IBAN:** AL29209415070000500061430102<br>**SWIFT:** FEFAALTRXXX | SHUKOS<br>Rr. "Bill Clinton", Objekti- "Iber-Lepenc", nr 13, kati I-re, Prishtinë,Kosove<br><br>**Banka:** NLB Prishtina sh.a<br>**Banka Ndërmjetëse:** LJBASI2X Nova Ljubljanska Banka dd, Ljubljana Slovenia<br>**Emri i përfituesit:** SHUKOS<br>**Nr. i llogarisë:** 17-00-200000018975<br>**IBAN:** XK051700200000018975<br>**SWIFT:** NLPRXKPR |
| SHËNIM: Ju lutemi paguani shumën e plotë të shënuar në faturë. Komisionet bankare i takojnë ekspozuesit. | |

## 6. FIRMA

Emri

Pozicioni

Data

Firma